

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot në Tiranë, më datë 13/01/2025:

Shoqëria MHE CORPORATION Sh.p.k, person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar në regjistrin tregtar në QKB më datë 27/12/2024, me numër unik identifikimi NIPT M42427014A, me seli në Tiranë, Farkë e Madhe, Shkallenjeve, Nd. 23, H. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm dhe njëherazi Administratori, Firdeus Shkalla, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. personal K41028037D, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë MHE CORPORATION Sh.p.k, nga këtu e më poshtë referuar si "Shitësi".

dhe

Mario David Odicini identifikuar nga pasaporta me nr. YB6959922, nga këtu e më poshtë referuar si "Blerësi".

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, me një vlerë totale prej ALL 1.000 (një mijë), që shitësi zotëron në shoqërinë MHE CORPORATION Sh.p.k me nr. NIPT M42427014A.

Neni 2

Çmimi i shitjes

Pala blerëse i paguan palës shitëse çmimin e shitjes 1.000 (një mijë) lekë për kuotat me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Çmimi i shitjes paguhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1. Kuotat e shituara nga pala shitëse të shoqërisë MHE CORPORATION Sh.p.k dhe çdo e drejtë dhe detyrim që buron prej tyre kalojnë/transferohen në pronësi të palës blerëse menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

3.2. Pala blerëse fiton pronësinë e kuotave me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentit të shitjes dhe do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të tyre, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore dhe palëve të treta.

Neni 4

Gjuha e kontratës dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë hartohet në 4 ekzemplarë, në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve do të marrë një kopje të kontratës. Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Firdeus Shkalla

Firdeus Shkalla
[Signature]



BLERËSI

Mario David Odicini

[Signature]
[Signature]